



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M
PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS TË QENDRËS PËR ZHVILLIM DHE MBROJTJEN E
MEDIAS SË RE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës të Qendrës për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Qendra për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re ka paraqitur kërkesën e saj me nr.Prot 11817 të datës 17.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 10 (dhjetë) vëzhguesve afatgjatë .

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe është jo i plotë pasi mungon vërtetimi i regjistrimit në gjykatë në bazë të të cilit verifikohet dhe objekti i veprimtarisë së organizatës



Nr. 845 i Vendimit

Data 21 .06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës të Qendrës për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Qendrës për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re , për akreditimin e 10 (dhjetë) vëzhguesve afatgjatë, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

